



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Në bazë të nenit 15., 16.2., 16.4.b. dhe 20. të Ligjit për Planifikim të Hapsirës nr. 2002/14, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, nenit 38.1. (b,c,d.) të dhe nenit 81. (h.i.) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të pikës V. të Vendimit mbi miratimin e Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, nr. 01-17735 të dt. 30.10/2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.05.2011, miraton këtë:

V E N D I M

Për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban: " LIVADHET E ARAPIT" në Gjilan

1.

Me këtë Vendim i qaset hartimit të Planit Rregullues Urban: "Livadhet e Arapit" në Gjilan, (në tekstin e mëtejshëm: PRRU) i cili do të përfshijë hapsirën (në anën e dhjathtë) duke filluar nga ura mbi lumin: "Mirusha" në qendër të Qytetit dhe vazhduar rrjedhës së poshtme të lumit deri te rrjedha e lumit "Banja" në lumin "Mirusha" afër tregut të gjelbërt dhe vazhduar afër kufirit të tregut deri te laka e rrugës lokale: Gjilan-Malishevë ku kthehet në drejtim të rrjedhës së poshtme të lumit, përkatësisht rrugës të cilën e përcjellë deri te rruga Kuvçë e Ultë-Zabel, ku kthehet në të djathtë dhe vazhdon deri te ura mbi lumin: "Mirusha" dhe pasi të kalojë lumin e përcjellë rrjetin e kanalizimit të lagjes së "Zabelit" deri te rruga Zabel-Gjilan (te prroi i lagjës së Arbërisë), ku kthehet në të dhjathtë dhe e përcjell rrugën deri në qendër të Qytetit para Hotelit: " Kristal", ku kthehet në të djathtë dhe deri te ura mbi lumin "Mirusha" në pikën fillestare, në sipërfaqe rreth 100 hektar.

2.

Me PRRU nga pika 1. e këtij vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të realizimit të PZHU: Qyetei I Gjilanit dhe harmonizimin e zhvillimeve të bëra me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit të tokës ndërtimore, ndërtimit të objekteve banimore-afariste dhe destinime tjera si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës publike dhe infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional kësaj zone dhe inkorporimin e sajë si pjesë e tërësisë së Qytetit të Gjilanit.

3.

PRRU, duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

4.

PRRU duhet të përmbajë: Pjesën tekstuale dhe Pjesën grafike. Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e planit duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara me U.A. për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05 dhe detyra projektuese.

5.

Gjatë hartimit të këtij plani, veqmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe tokës ndërtimore;
- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese si dhe organizimin e ndërtimeve të reja përbrenda kufinjëve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke patur parasysh kushtet urbanistiko teknike dhe hapësimore si dhe mundësinë e harmonizimit të interesave publiko-private;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të karakterit të përgjithshëm publik me përmbajtje përcjellëse (objekteve të asrimit, edukimit, shëndetsisë, mirëqenjes sociale, kulturës, sportit, administratës publike etj);
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse (rrjetit primar të rrugëve, gjelbrimit, hapsirave të lira publike, me theks të veqante për rregullimin e shtretërve të lumenjëve dhe rrjedhave të projeve, rrjeteve primare të ujësjellsit, kanalizimit fekal dhe atmosferik, kolektorit, rrjetit të përquesve elektrik, telekomunikes, etj);
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave mjedisore, natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;

- mbrojtjen e ambientit jetësor dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare me theks të veqante rregullimin e shteretërve të lumenjëve, rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik, impiantit për trajtimin e ujrave të zeza, etj.
- kushtet hapësinore dhe urbanistike të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm publik;

6.

Bartës i Menagjimit të procesit të hartimit të këtij plani, caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ësGjilan.

7.

Draftdokumenti final- Projekti i këtij Plani, duhet vënë në shqyrtim publik dhe komente.

8.

Koha dhe vendi për shqyrtim publik dhe dhënjën e komenteve duhet të duhet të shpallen në mjetet e informimit.

9.

Financimi i hartimit të plotësimeve të këtijë plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit.

Financimi mundë të bëhet edhe nga partneriteti publiko-privat, donatorët dhe komuniteti.

10.

PRrU do të hartohet për periudhën 5 vjeqare.

11.

Mbi zbatimin e këtijë Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani.

12.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

01.Nr. 16/7085
Gjilan, më 30.05.2011.

Kuvendi i Komunës,
Izmi ZEKA, Kryesues

A r s y e t i m
i Vendimit për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban: "Livadhet e Arapit"

Bazë juridike për propozimin për miratimin e Vendimit për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban: "Livadhet e Arapit" janë dispozita e Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimet Administrative për zbatimin e LPH mbi elementet themelore të Planit Rregullues Urban dhe Udhëzuesit mbi propozimin për marrjen e vendimit për hatrimin e PZHK, PZHU dhe PRrU, Statuti i Komunës së Gjilanit, Vendimi i KK-ës Gjilan për miratimin e Planit Zhvillimor Urban, nr. 01.11735, dt. 30.10 2008.

PRrU: " Livadhet e Arapit" është një tërësi hapësinore kompakte e ndërlidhur dhe e shtrir nga pjesa jug-lindore e Qytetit të Gjilanit dhe me intereferime të drejtëpërdrejta edhe në pjesët jugperëndimore dhe juglindore të Qytetit dhe jasht tij.

Kjo hapësirë në një sipërfaqe rreth mbi 100 hektar, është pjesërisht e ndërtuar në të dy anët e rrugës Gjilan-Malishevë, e atakuar me ndërtim –banim individual pa infrastruktur rrugore dhe infrastruktur tjetër komunale dhe objekte të karakterit publik, përveq unazës "Jugu 1", dhe rrugës së papërfunduar: Kuvçë e Ultë-Lumi "Miruasha" në drejtim të Zabelit, të shtratit pa përfunduar të lumit: "Mirausha".

Me këtë Planifikim do të tentohet, që duke u bazuar në situatën aktuale dhe kriteret e Planit Zhvillimor Urban në fuqi, të parashifen mundësit e organizimit hapësinor dhe harmonizimin e gjendjes ekzistuese me gjendjen e planifikuar dhe të ndërtimit të objekteve të banimit, dhe afarizmit, ndërtimin e objekteve të karakterit të përgjithshëm public: objekteve të arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, etj., përmbajtje dhe objekte të infrastruktures teknike komunale: rrugëve primare dhe sekondare, trotoareve, stazave dhe aleve të ndryshme, hapsirave të lira dhe gjelbërimit, rregullimit të rrjeteve të ujësjellësit, kalalizimit atmosferik dhe fekal, etj., rregullimin e shtretërve të lumenjëve, me qëllim të krijimit të kushteve dhe mundësive për një jetë dhe veprim të mir organizuar dhe mundësisë për zhvillim bashkohor dhe të qëndrueshëm, ndërlidhjen me pjesër tjera brenda qytetit dhe jasht saj, (Unazën e jashtme të pjesë jugore të Qytetit të Gjilanit, (Livoq i Ultë- Velekincë- Zabel -Shillovë).

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit

Gjilan, Maj / 2011.